

Autor:

Dr. Musli Vërbani

Titulli:

RUKJE PËR VETE

Kaçanik, 2025

HYRJE

Bismil-Laahirr-Rrahmaanirr-Rrahhiimë

Si duhet të veprojë personi i cili ballafaqohet me situata të rënda shpirtërore?

Personi i cili ballafaqohet me situata të rënda shpirtërore dhe i cili dëshiron të triumfojë kundër shejtanëve, thjesht e këndon “Eudhubilahin” (**Eudhu bil-lahi minesh-shejtanirr-rraxhiimë** - Kërkoj mbrojtje tek Allahu që të më mbrojë nga shejtani i mallkuar).

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Dhe kur të cytë shejtani me ndonjë cytje, atëherë kërko mbrojtje nga Zoti. Pa dyshim se Ai dëgjon dhe është i Ditur”**. Për këtë arsye, kusht i rukjes është gjuha arabe dhe nuk lejohet që të bëhet as me simbole, as me shenja.

ME SHKRONJA ARABE DHE ME TRANSLITERIM

1. Lexo tri herë herë Fatiha-n

Bismil-Laahirr-Rahmaanirr-Rrahiimë

Elhamdu lil-Laahi Rabbil Aaleminë

Err Rahmaanirr Rrahiimë

Maaliki Jevmid diinë.

Ijzjaake neabudu

Ve ijzake nesteiinë

Ihdines siraatal Mustekiimë

Siraatal ledhiine en'amte alejhim

Gajril Magduubi alejhim ve ledd daaal-liinë.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ﴿١﴾ الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ
الْعَالَمِينَ ﴿٢﴾ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ﴿٣﴾ مَالِكِ يَوْمِ
الدِّينِ ﴿٤﴾ إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ ﴿٥﴾
اهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ ﴿٦﴾ صِرَاطَ الَّذِينَ
أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا
الضَّالِّينَ ﴿٧﴾

2. Lexo tri herë herë Ajetul Kursinë (Tebih dova)

All-Ilaahu Laa Ilaahe il-laa huvel-Hajjul-Kajjumu,
Laa teëhudhuhuu sinetun ve laa nevmun,
lehuu maa fis-semaavaati ve maa fil-erdi,
men dhel-ledhii jeshfeu indehuu il-laa bi
idhnihii,
jealemu maa bejne ejdiihim ve maa halfehum
ve laa juhituune bi shej`in min ilmihi il-laa bima
shaae
vesi'a Kursijjuhus-semaavaati vel-erdaa,
ve laa jeuuduhuu hifdhuhumaa
ve huvel-Alijjul-Adhim.

(El-Bekare: 255)

اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ ۚ لَا تَأْخُذُهُ سِنَّةٌ وَلَا نَوْمٌ ۚ لَهُ
مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ ۚ مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ
إِلَّا بِإِذْنِهِ ۚ يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ ۚ وَلَا يُحِيطُونَ
بِشَيْءٍ مِّنْ عِلْمِهِ إِلَّا بِمَا شَاءَ ۚ وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَاوَاتِ
وَالْأَرْضَ ۚ وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا ۚ وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ

3. Lexo tri herë këto ajete:

Em jabsuduunen naase alaa maa
aataahumullaahu min fadlihii.
ve lekad aatjenaa aale ibraahiamel kitaabe
vel hikmete
ve aatejnaahum mulken adhimen.

(Nisa, 54)

أَمْ يَحْسُدُونَ النَّاسَ عَلَى مَا آتَاهُمُ اللَّهُ مِنْ
فَضْلِهِ ۖ فَقَدْ أَتَيْنَا آلَ إِبْرَاهِيمَ الْكِتَابَ
وَالْحِكْمَةَ وَآتَيْنَاهُمْ مُلْكًا عَظِيمًا

4. Lexo tri herë këto ajete:

Ve in jekaadul ledhine keferuu li
juzlikuuneke lemmaa semiudh dhikre
ve jekulune le mexhnuunë
maa huve il-laa dhikrun lil aalemiinë.

(Kalem, 51)

وَإِنْ يَكْذِبُ الَّذِينَ كَفَرُوا لَنُزَلِّقُنَكَ
بِأَبْصَارِهِمْ لَمَّا سَمِعُوا الذِّكْرَ وَيَقُولُونَ إِنَّهُ
لَمَجْنُونٌ

5. Lexo tri herë suren Ihlas

Bismil-Laahirr-Rahmaanirr-Rrahiimë

Kul huvall-Llaahu Ehadë

All-Ilahus Samedë

Lem Jelidë

Ve lem Juledë

Ve lem jekun lehu kufuven Ehadë.

قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ ﴿١﴾ اللَّهُ الصَّمَدُ ﴿٢﴾ لَمْ يَلِدْ
وَلَمْ يُولَدْ ﴿٣﴾ وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ ﴿٤﴾

6. Lexo tri herë suren Felek

Bismil-Laahirr-Rahmaanirr-Rrahiimë

Kul eudhu bi Rabil Felekë

Min sherri ma halek

Ve min sherri gaasikin idha vekab

Ve min sherri neffathaati fil ukad

Ve min sherri hasidin idha hased.

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ ﴿١﴾ مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ
﴿٢﴾ وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ ﴿٣﴾ وَمِنْ شَرِّ
النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ ﴿٤﴾ وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا
حَسَدَ ﴿٥﴾

7. Lexo tri herë suren Nas

Bismil-Laahirr-Rahmaanirr-Rrahiimë

Kul Euudhu bi Rabbin Naasi

Melikin Naasi

Ilahin Naasi

Min sherril Vesvasil han naasi

El-ledhii juvesvisu fii suduurin-naasi.

Minel Xhinneti ven Naasi.

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ ﴿١﴾ مَلِكِ النَّاسِ ﴿٢﴾
إِلَهِ النَّاسِ ﴿٣﴾ مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ الْخَنَّاسِ ﴿٤﴾
الَّذِي يُوسْوِسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ ﴿٥﴾ مِنَ الْجِنَّةِ
وَالنَّاسِ ﴿٦﴾

8. Lexo tri herë:

All-Ilaahume Rabbin naase
idhhebil beëse
veshfi
ente shaafi
laa shifaae il-laa shifaaue
shifaaen laa jugaadir sekamen.

اللَّهُمَّ رَبَّ النَّاسِ،
أَذْهِبِ الْبَاسَ، وَاشْفِ،
أَنْتَ الشَّافِي
لَا شِفَاءَ إِلَّا شِفَاؤُكَ،
شِفَاءٌ لَا يُغَادِرُ سَقَمًا

9. Lexo tri herë:

Bismilahi erkijke
Vall-Ilaahu jeshfiikë
min kuli daain juëdhijkë
ve min kul-li nefsin
ev ajnin haasidin
All-Ilaahu jeshfiikë
Bismil-lahi erkiikë.

بِسْمِ اللَّهِ أَرْقِيكَ
وَاللَّهُ يَشْفِيكَ
مِنْ كُلِّ دَاءٍ يُؤْذِيكَ
وَمِنْ كُلِّ نَفْسٍ
أَوْعَيْنٍ حَاسِدٍ
اللَّهُ يَشْفِيكَ
بِسْمِ اللَّهِ أَرْقِيكَ

10. Lexo tri herë

Euudhu bi kelimaatilaahi
min sherri maa haleka.

اعُوْذُ بِكَلِمَاتِ اللّٰهِ
مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ

11. Lexo tri herë

Eudhu bi kelimaatil laahi taammeti
min sherr rri maa haleka
min kul-li shejtaanin
ve haametin
ve min kul-li ajnin alametin.

أَعُوذُ بِكَلِمَاتِ اللَّهِ الثَّامَّةِ
مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ
مِنْ كُلِّ شَيْطَانٍ
وَهَامَّةٍ،
وَمِنْ كُلِّ عَيْنٍ لَامَّةٍ

12. Lexo tri herë:

Eudhu bi kelimatilahi tameti
Min gadabihi
ve min sherr-rrî ibaadihii
ve min hemezaatish shejaatinë
ve en jahduruunë.

أَعُوذُ بِكَلِمَاتِ اللَّهِ التَّامَّاتِ
مِنْ غَضَبِهِ
وَشَرِّ عِبَادِهِ
وَمِنْ هَمَزَاتِ الشَّيَاطِينِ
وَأَنْ يَحْضُرُونِ

13. Lexo tri herë:

Bismilaahil- ledhii la jedurr-rru mea-ismihii
shejun fil erdi ve laa fis semaai
ve huves semiilu aliimë.

بِسْمِ اللَّهِ الَّذِي لَا يَضُرُّ مَعَ اسْمِهِ
شَيْءٌ فِي الْأَرْضِ وَلَا فِي السَّمَاءِ
وَهُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ

A lejohet hapja e ordinancave për Rukje?

Hapja e ordinancave, klinikave, zyrave apo vendeve të caktuara për t'i shëruar njerëzit me Kur'an (për Rukje) është bid'at të cilën nuk e ka praktikuar as Muhamedi a.s., as sehabet, as gjenerata e hershme islame dhe: ***“Çdo shpikje është bid'at, çdo Bid'at është devijim dhe çdo devijim shpie në zjarr.”***

“Ai që shpik në këtë fe diçka që s'është pjesë e saj, do të jenë të refuzuar.” !?

Të merret “rukja” si profesion dhe të hapet diçka e ngjashme me klinikat apo spitalet, nuk është vepruar nga askush tjetër përveç dashakeqësve të islamit. Ata kanë shfrytëzuar shumë gënjeshtër, në mënyrë që të hanë pasuritë e njerëzve padrejtësisht, kështu që kanë filluar të hapin “klinikat të rukjes” me pretendimin se kjo është “Rukje sheriatike”.

Ata kanë trilluar gënjeshtër dhe besëtytni, dhe janë fshehur në sy të njerëzve me anë të

leximit të Kur'anit, dhe kësisoj janë tallur me njerëzit. Për shkak të kësaj kanë bërë shumë dëme të cilat nuk numërohen e as llogariten.

Disa që bëjnë rukje i shtojnë metodat e rukjes me qëllim që të grumbullojnë sa më shumë pasuri.

Ata të cilët hapin ‘qendra klinike’ apo ‘zyra ambulante’ le të dihet se, islami nuk ka asgjë të përbashkët me ta, por ky lloj veprimi është bidat, të cilin e kanë shpikur njerëzit e kohës së sodit, sepse ky nuk është veprim as i sahabëve, as i gjeneratave të para, ndërsa dihet se çdo bidat shpie në humbje dhe çdo humbje shpie në zjarr, pra “rukjen” të cilën e kanë shpikur këto njerëz është bidat në islam dhe nuk buron nga sahabët ashtu siç pretendojnë këta bidatgjinj.

RUKJA DHE PRAKTIKIMI BASHKËKOHORË

Rukja dhe praktikumi bashkëkohor i saj nuk kanë të bëjnë me atë të cilën e kanë lejuar dijetarët.

Mënyra se si bëhet ‘rukje’ në këtë kohë, nuk është sipas sheriatit dhe kjo mënyrë nuk është vepruar në kohën e gjeneratave të para. Nëse dikush e përdor si argument hadithin e Ebu Seid el Hudrijut r.a. kur ai me shokët e tij kërkuan të priten si mysafir nga një fis por ata nuk i mirëpritën por i refuzuan, e që më pas kryetari i këtij fisi ishte kafshuar (nga një gjarpër ose akrep), kështu që, ata filluan që të kërkonin dikë për ta shëruar nga helmi i gjarprit dhe Ebu Seidi dhe sehabet që ishin me të u thanë: Po, ne do të bëjmë lutje për të. Ai u tha atyre: Betohem në Allahun, unë vërtet bëj rukje, por ju nuk na mikpritët si mysafir, andaj ne nuk do t’i bëjmë rukje atij përderisa ju të na jepni ndonjë shpërblim. Ata u dhanë një tufë dele, kështu që Ebu Seidi i këndoi atij suren “El Fatiha”. Muhamedi a.s. e aprovoi këtë, e madje tha: “Më jepni edhe mua një pjesë (të

mishit).” Ky hadith është i vërtetë, por argumentimi me të është i paqëndrueshëm, sepse ata kishin arsye përse morën dhuratë dhe arsyeja ishte se ai fis ishin koprrac, kështu që ata u ndëshkuan për shkak të refuzimit të kërkesës së tyre. Asnjëri nga sahabët nuk e mori këtë rast si shkas që të hapë ‘klinika’ për të bërë rukje. Në qoftë se ky veprim do të ishte i lejuar, ata (sahabët) do të na kishin paraprirë neve sepse ata ishin më të interesuarit për të qenë më të dobishëm për njerëzit dhe për ta zbatuar sunetin.

NGRËNIA E PASURISË SË NJERËZVE ME PA TË DREJTË

Veprimet që ne i shohim si f.v.: shishe në disa shitore me ambalazhe si: “kjo është rukje e filanit”, dhe rastet tjera si thëniet: “rukja e filanit shitet më shtrenjtë se rukja e alanit”, me pretekste banale se ky ‘hoxhë’ është më i fortë se ky tjetri. Këta që po praktikojnë këtë lloj rukje në esencë janë duke u marrë me magji (mashttrim), gënjeshtër, marrëzi dhe ngrënie të pasurisë së njerëzve me pa të drejtë.

Nuk ka argument se sahabët e kanë hapur shtëpinë me pretendimet se: Unë shëroj me Kur’an, apo jam i specializuar të shëroj me Kur’an, e edhe peygamberi s.a.v.s. nuk e ka bërë një gjë të tillë, përkundrazi Muhamedi s.a.v.s. për shërim e ka **ligjësuar mjekësinë**.

Nuk ka argumente se sahabët kanë hapur ‘ordinanca’ dhe kanë thënë se “largojnë xhinët nga trupi i njeriut”. Veprimet e tilla nuk kanë të bëjnë asgjë me islamin.

Disa njerëz e shfrytëzuan këtë bidat për të shitur “ujë” në të cilin është bërë rukje apo që është fryrë në të.

Disa të tjerë janë duke bërë tregti me ullinj, vajin e ullirit, për të shitur “ujë” në të cilin është bërë rukje apo që është fryrë në të.

Disa të tjerë janë duke bërë tregti me mjaltë, saqë tani çmimin e tyre e kanë bërë të papërballueshëm për njerëzit.

Disa të tjerë janë duke bërë tregti me fara të zeza, saqë tani çmimin e tyre e kanë bërë të papërballueshëm për njerëzit.

Kësisoj është duke u bërë çrregullim (fitne). Ata e blejnë një shishe me vaj ulliri, kurse të njëjtën e shesin me çmim të dyfishuar (apo shumëfishuar) me pretendimin se në të është kënduar Kur'an.

Veprimet e këtilla e bëjnë të ndaluar (haram) marrjen e rukjes për profesion, ashtu siç e kanë bërë zakon disa.

ZËVENDËSIMI I GJENERATAVE TË NJERËZVE DHE XHINËVE

Allahu i Madhërishëm thotë: **“Për ta është marrë vendimi përfundimtar (të jenë banorë të zjarrit) si për popujt nga xhinët po ashtu edhe nga njerëzit që kanë kaluar para tyre, sepse ata ishin të devijuar.”**
(*Ahkaf,18*)

Ky ajet i suretul Ahkafë është dëshmi se, sikurse ndërrohen gjeneratat e njerëzve, ashtu ndërrohen edhe gjeneratat e xhinëve. Me fjalë tjera: shkon njëra gjeneratë e njerëzve dhe zëvendësohet me gjeneratën tjetër të njerëzve, po ashtu shkon një gjeneratë e xhinëve dhe zëvendësohet me gjeneratën tjetër të xhinëve.

RUKJA

Rukje, është fjalë e cila nënkupton diçka që largon të keqen, pra mbrojtje nga e keqja, e padëshiruara, ose shërim për të sëmurin.

Rukje, konsiderohet lëshimi i ajrit të kondensuar prej fytit. Në të kaluarën është thënë “me fry”.

Arabët paraislamik besonin në këtë besëtytni, ndërsa islami rukjen e sheh si diçka që nuk ka ndikim pa dëshirën e Allahut.

Ka ardhur tekst i drejtpërdrejtë për refuzimin dhe ndalimin e Rukjes. Muhamedi a.s. për ata që hyjnë në xhenet ka thënë: ***“janë ata të cilët: as nuk kërkojnë t’u bëjnë rukje, as nuk bëjnë rukje, dhe as nuk merren me hajmali, por i mbështeten Zotit të tyre.”***

Bërja e rukjes është prej veprimeve të urryera në Islam.

Kërkesa që të bëhet rukje është prej veprimeve të urryera në Islam.

Transmetohet nga Ibn Mesiu r.a. se ai ka hyrë te gruaja e tij dhe kur sheh diçka të varur në qafën e saj, ia heq prej qafe dhe i thotë: Ka ardhur Umeti i Muhamedit a.s. që të mos i bëhet idhujtari Allahut, në çështje për të cilat nuk ka njohuri dhe të mos bëjnë “Tilvete”.

I thonë: O Abdurrahman, sa i përket dukurisë së rukjes dhe hajmalisë e dimë, por çka është “Tilvete”.

Është përgjigjur: (Tilvete është) Veprimi, të cilin e bëjnë gratë, për të qenë të dashura te burrat e tyre. Hajmalitë i kanë vendosur në trupin e fëmijës për t'i larguar nga mësyshi dhe xhinët.

Muhamedi a.s. ka thënë. **“Rukja, Hajmalia dhe Tilvete janë idhujtari.”**
(Transmeton Ahmedi, Ebu Davudi, Bejhekiu dhe Hakimi, ndërsa e ka vërtetuar edhe Dhehebiu).

DALLIMI NË MES RUKJES DHE LUTJES

Ka dallim në mes të lutjes për shërim dhe rukjes.

Askund nuk përmendet se Rukja është “shërimi me Kur’an dhe Sunet” ashtu siç pretendojnë rukjexhitë.

“Lutjet për shërim” janë lutje për shërim të cilat mund të lexohen në Kur’an duke e mësuar Kur’anin dhe jo duke e lënë pas dore dhe në duart e të tjerëve. Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Ne shpallim nga Kur’ani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët e që mohuesve keqbërës u shton vetëm humbje.”** (*El Isra : 82*)

Allahu nuk ka zbritur nga qielli ndonjë shërues më të dobishëm se sa Kur’ani, i cili është shërim nga sëmundja e injorancës, e dyshimit, etj.

Allahu nuk ka zbritur nga qielli ndonjë më gjithëpërfshirës se sa Kur’ani.

Allahu nuk ka zbritur nga qielli ndonjë shërues më të mirë se sa Kur’ani, i cili është shërim për zemrat nga sëmundja e pasigurisë, etj.

Muslimani duhet të lexojë sa më shumë Kur'an, ose të dëgjojë sa më shumë. Nëse nuk mund të lexojë, atëherë duhet të përpiqet sa më shumë që të mësojë të lexojë Kur'anin arabisht, sepse kështu ai e ruan veten dhe shtëpinë e tij nga çdo e keqe dhe e lidh veten me Allahun e Madhëruar dhe kështu nuk mbetet vend për të keqen, as për stres e as për sëmundje, as për magji e as për xhin, por vetëm për melek, mirësi, e pas kësaj Allahu është Ai i cili e ka në dorë suksesin, prandaj lutjuni Allahut sa më shumë.

Nëse rukja do të kishte efekt shërues mbi një femër e cila kurrë nuk falet dhe nuk i kryen obligimet e saj dhe është e zhytur në mëkate dhe prapë mendon të vazhdoj jetën si e tillë, atëherë çfarë dobie ka rukja te ajo, kur edhe pas rukjes vazhdon të jetojë e tillë. A mund të ketë rukja efekt shërimi për të? A mund të ketë këndimi i Kur'anit efekt shërimi te ta? Kurrresi jo!

Nëse rukja do të kishte efekt shërues mbi një mashkull i cili kurrë nuk falet dhe nuk i kryen obligimet e tij, dhe është i zhytur në

mëkate, dhe prapë mendon të vazhdojë jetën si i tillë, atëherë çfarë dobie ka rukja te ai, kur edhe pas rukjes vazhdon të jetojë i tillë. A mund të ketë rukja efekt shërimi për të? A mund të ketë këndimi i Kur'anit efekt shërimi te ta? Kurrresi jo!

MENDIMI I DIJETARËVE PËR RUKJE

Dijetarët të cilët e kanë lejuar rukjen, e kanë lejuar me tre kushte:

1. Të përmendet Allahu;
2. Emrat e tij të përmenden në gjuhën arabe;
3. Të dihet se rukja nuk ka ndikim në vetvete, por shërimi është prej Zotit.

Përderisa, dijetarët i kanë ndaluar hajmalitë, pa marrë parasysh pa ajete të Kur'anit apo me ajete të Kur'anit.

Kur'ani është shërim i zemrave, ai largon nga mëdyshjet, injoranca, besimi i verbër, pikëllimet, vështirësitë, brengat, mërzitë, etj. Për këtë arsye, Muhamedi a.s. ka bërë këtë lutje:

“O Zot! Bëje Kur'anin qetësim të zemrës sime, dritë të gjoksit tim. Largim të mirësisë sime. Largues të brengave dhe vështirësive të mia.”

Islami e ka lejuar shërimin me barna shpirtërore si p.sh.: njeriu lutet për vete dhe për të sëmurin:

“O Zot, o Përkujdesës i njerëzve, largoje këtë vështirësi, shëro, Ti je shërues, nuk ka shërim nëse Ti nuk shëron, shëro me shërimin me të cilin nuk ndihen dhembjet.” (Ahmedi dhe Buhariu).

Këtë lutje mund ta bëjë çdo njeri për veten e tij por edhe për tjetrin, por kurrësi ta bëjë profesion “rukjen/lutjen” dhe të përfitohet prej saj.

A është shërimi me Kur'an Rukje?

Kush thotë se shërimi me Kur'an është rukje, ai e ka shpikur këtë term, që do të thotë se ky term nuk është përdorur prej sahabëve por është term i mëvonshëm, sepse shërimi me Kur'an është shërim me Kur'an, dhe shërimi me sunet është shërim me sunet dhe nuk është rukje, pra nuk dihet se ndonjëri prej dijetarëve islam e ka determinuar ashtu.

Zemra i nënshtrohet Allahut dhe e pranon Librin e Tij, dhe nëse njeriu ka vendosmëri të fortë në shërimin me Librin e Allahut dhe me lutjet pejgamberike, atëherë njeriu shërohet me shërim të plotë nga Allahu i Madhëruar, sepse në këtë rast ka ndodhur ajo që ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.:

“Për çdo sëmundje ka ilaç dhe nëse qëllohet ilaçi i sëmundjes, njeriu shërohet me lejen e Allahut.” (Muslimi)

Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Pyete ekspertin për çështje”** me këtë nënkuptohet se ekspertët pyeten në çdo lëmi, pa marrë parasysh a bëhet fjalë për

çështje të fesë apo të dunjasë, p.sh., për ndërtim pyetet arkitekti, për bujqësi agronomi, e në rastin tonë për mjekësi pyetet mjeku.

RRETH SIHRI (MAGJISË)

Disa njerëz e kanë bërë sihrin Zot.

Disa njerëz mendojnë se xhinët e sundojnë botën.

Në bazë të Kur'anit, Xhini nuk mund ta sundojë njeriun.

Në bazë të Kur'anit, Xhini nuk mund të hyjë brenda në trup të njeriut.

Disa njerëz çdo dështim të jetës ia përshkruajnë sihrin (magjisë).

Disa njerëz çdo problem të jetës ia përshkruajnë sihrin (magjisë).

Disa njerëz çdo sëmundje ia përshkruajnë sihrin (magjisë).

Muslimani nuk duhet të dorëzohet para iluzioneve se ndonjë njeri është në gjendje ta nxjerrë Ifritin -Xhin nga trupi i njeriut nga shkaku se i është bërë magji.

Në bazë të Kur'anit, Xhini nuk mund t'i hyjë njeriut dhe ta dirigjon.

Në bazë të Kur'anit, njeriu është sundues-halife në tokë. Kjo për faktin se xhinët nuk

e kanë merituar të jenë udhëheqës në tokë, por bijtë e Ademit (njerëzit) janë ata të cilët janë sundimtarë (Udhëheqës-Halife) në tokë.

Bindja se xhini e dirigjon njeriun nuk ka bazë Kur'anore. Përkundrazi, Zoti i Madhërishëm na tregon në Kur'an se çka do të thotë Shejtani në botën tjetër: **“(do të thotë): Po unë nuk pata kurrfarë pushteti (sundimi-dirigjimi) ndaj jush, përpos që ju thirra (në rrugë të gabuar), e ju m'u përgjigjët, atëherë, pra mos më qortoni mua, po qortojeni veten”.** (Ibrahimë, 22)

ÇKA NËNKUPTOJMË ME FJALËN “MES” (PREKJEN) E SHEJTANIT?

Sa i përket ajetit **“nuk ngrihen ndryshe pos siç ngrihet i çmenduri nga të prekurit e Shejtanit.”** (*Bekare*, 275)

Termi “mes-prekje” nuk e ka kuptimin e hyrjes në trup.

Termi “mes-prekje” nuk e ka kuptimin e sundimit, dirigjimit dhe të kontrollimit.

Sihri ka kuptimin e ndonjë lëvizje të lehtë, nuk e ka kuptimin e mbizotërimit dhe të dirigjimit.

ÇKA NËNKUPTOJMË ME FJALËN “NASB”?

Sa i përket ajetit: **“kur (Ejubi) me lutje iu drejtua Zotit të vet: “Shejtani më ka goditur me “nasb-mundim” e dhembje!”** (*Sad*, 11).

Fjala “nasb” ka kuptimin e se “e ka nxitë, ka krijuar hamendje (vesvese) se Allahu është hidhëruar me Ejubin dhe e ka lënë pas dore dhe se do të vazhdon sëmundja.”

Pretendimi se shejtani e lëndon ndonjë person nuk do të thotë se shejtani ka hy në trup të njeriut dhe e dirigjon. Përkundrazi Kur’ani tregon të kundërtën.

Pse?

- Sepse bijtë e Ademit janë sundimtarë në tokë dhe jo xhinët (*Bekare*, 30).

Zoti e ka çliruar njeriun nga sundimi i shejtanit, ashtu siç thuhet në ajetin në vijim: **“Përpos atyre të cilët zhyten në vesveset e tij (shejtanit), e ndaj robërve të Mi (të singertë) nuk ke kurrfarë force (as fizike as mendore), përveç atyre të humburve që vijnë pas teje.”** (*Hixhr*, 42).

Shejtani në ditën e gjykimit do të thotë: **“Po unë nuk pata kurrfarë pushteti (sundimi) ndaj jush, përpos që ju kam ftuar (në rrugë të gabuar), e ju m’u përgjigjët, andaj, mos më qortoni mua, po qortojini vetët tuaja.”** (Ibrahim, 22)

Nga ajeti kuptohet se te ata të cilët kanë devijuar nga rruga e drejtë, shejtani ka krijuar vesvese. Pra, Shejtani thotë: **“Ju kam ftuar, më jeni përgjigjur.”** (Ibrahim, 22).

NJERIU E KA SUNDUAR XHININ DHE JO E KUNDËRTA

Njeriu e ka sunduar xhinin dhe jo e kundërta, xhini nuk e ka sunduar dhe nuk mund ta sundon njeriun.

Sulejmani i ka nënshtruar xhinët, dhe kjo ka ndodhur pasi që e ka lutë Allahun për pushtet, aso pushteti të cilin nuk do ta ketë askush pos tij.

Allahu i është përgjigjur lutjes së tij pozitivisht, ku thotë: **“Ne ia nënshtruam erën që, sipas urdhrit të tij, ajo të ecën lehtë dhe nga të dëshiron ai. Ndërsa shejtanët (ia nënshtruam) për çdo ndërtim dhe zhytje në ujë. Dhe të tjerët (shejtan) që ishin të lidhur në pranga”.** (Sad, 36-38)

Pastaj Sulejmani a.s. ka vdekur. Mirëpo kur ka vdekur Sulejmani a.s., Xhinët nuk kanë kuptuar asgjë për vdekjen e tij, gjë që tregon se Xhinët nuk e dinë gajbin (të fshehtën), gjë

që tregon se xhinët nuk mund t'i kalojnë
muret.

XHINI IFRIT DHE NJERIU I DITUR

Sa i përket ajetit: **“E Sulejmanit i ishte tubuar ushtria e vet që përbëhej nga xhinët, nga njerëzit dhe nga shpendët dhe ata mbanin rendin.”** (*Neml*, 17)

Kur Sulejmani ka kërkuar nga të pranishmit për të sjell para tij frontin e Belkisës:

- Ifriti Xhin ka qenë i paaftë për të sjell fronin e Belkisës te Sulejmani.

- Njeriu i ditur e ka sjell fronin e Belkisës te Sulejmani.

Në mbledhjen të cilën e ka organizuar Sulejmani a.s. kanë marrë pjesë ushtria e xhinëve, njerëzve dhe e shpendëve.

Në mbledhje nuk kanë marrë pjesë melaqet sepse Allahu nuk ia ka nënshtuar melaqet Sulejmanit. Por njeriu i ditur ia ka sjellë fronin e Belkisës Sulejmanit a.s.

LEXO RUKJE PËR VETEN TËNDE

Muhamedi a.s. na ka mësuar ta bëjmë këtë lutje për veten tonë dhe jo domosdoshmërisht duhet ta bëjnë të tjerët për ne:

**“O Zoti im,
bëje Kur’anin dritë të gjoksit tim,
largues të pikëllimit tim,
lehtësues të brengave të mia dhe
fatkeqësive të mia.”**

1. Lexo tri herë herë Fatiha-në

Bismil-Laahirr-Rahmaanirr-Rrahiimë

Elhamdu lil-Laahi Rabbil Aaleminë

Err Rahmaanirr Rrahiimë

Maaliki Jevmid diinë.

Ijjaake neabudu

Ve ijake nesteinë

Ihdines siraatal Mustekiimë

Siraatal ledhiine en'amte alejhim

Gajril Magduubi alejhim ve ledd daaal-liinë.

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit!

Lavdërimet i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve,
Mëshirëbërësit, Mëshiruesit,
Sundimtarit (Gjykatësit Suprem) të Ditës së Gjykimit.
Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë
kërkojmë.

Udhëzona (na përforco) në rrugë të drejtë!

Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi, e jo në të
atyre që kanë tërhequr zemërimin Tënd, as në të
atyre që kanë të devijuar dhe janë të humbur!

2. Lexo tri herë herë Ajetul Kursijën

**All-llaahu Laa Ilaahe il-laa huvel-Hajjul-Kajjumu,
Laa teëhudhuhuu sinetun ve laa nevmun,
lehuu maa fis-semaavaati ve maa fil-erdi,
men dhel-ledhii jeshfeu indehuu il-laa bi idhnihii,
jealemu maa bejne ejdiihim ve maa halfehum
ve laa juhituune bi shej`in min ilmihii il-laa bima shaae
vesi'a Kursijjuhus-semaavaati vel-erdaa,
ve laa jeuuduhuu hifdhuhumaa
ve huvel-Alijjul-Adhim.**

All-llahu është Një, s`ka Zot tjetër përveç Atij, Ai është mbikëqyrës i përhershëm dhe i përjetshëm.

Atë nuk e zë as kotja as gjumi;

Gjithçka ka në qiej dhe në tokë është vetëm e Tij.

Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai, pos me lejen e Tij.

Ai e di të tashmen që është pranë tyre dhe të ardhmen.

Nga ajo që Ai di, të tjerët dinë vetëm aq sa Ai ka
dëshiruar.

Kursija e Tij përfshin qiejt dhe tokën,
kurse kujdesi i Tij ndaj të dyjave nuk i vjen
rëndë,

Ai është më i Larti, më i Madhi.

3. Lexo tri herë ajetin në vijim:

**Em jabsuduunen naase alaa maa
aataahumullaahu min fadlihii.
ve lekad aatjenaa aale ibraahimel kitaabe
vel hikmete
ve aatejnaahum mulken adhimen.**

A mos po kanë zili në atë çka Allahu u ka
dhënë nga begatitë e Tij
Ne i kemi dhënë Familjes së Ibrahimit librin
dhe urtësi,
i kemi dhënë pasuri dhe sundim të madh.

4. Lexo tri herë ajetin në vijim:

**Ve in jekaadul-ledhine keferuu li
juzlikuuneke lemmaa semiudh-dhikre
ve jekulune le mexhnuunë
maa huve il-laa dhikrun lil aalemiinë.**

Pabesimtarët dëshirojnë që të të përpijnë
me sytë e tyre atëherë kur dëgjojnë
Kur'anin.

Dhe thonë: Është i çmendur.

Ky është libër për gjithë botët.

5. Lexo tri herë suren Ihlas

Bismil-Laahirr-Rrahmaanirr-Rrahiimë

Kul huvall-Llaahu Ehadë

All-Ilahus Samedë

Lem Jelidë

Ve lem Juledë

Ve lem jekun lehu kufuven Ehadë.

Me emrin e Allahut,

Mëshiruesit, Mëshirëplotit.

Thuaj: “Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm!

Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim.

Ai as lind,

as është i lindur.

Dhe askush nuk është i barabartë (apo i krahasueshëm) me Atë!”

6. Lexo tri herë suren Felek

Bismil-Laahirr-Rrahmaanirr-Rrahiimë

Kul eudhu bi Rabil Felekë

Min sherri ma halek

Ve min sherri gaasikin idha vekab

Ve min sherri neffathaati fil ukad

Ve min sherri hasidin idha hased.

Me emrin e Allahut,

Mëshiruesit, Mëshirëplotit!

Thuah: “Kërkoj mbështetje te Zoti i agimit,
që të më mbrojë nga sherri i gjithçkaje që Ai
ka krijuar,
dhe nga sherri i natës kur kaplon terri,
dhe nga sherri i falltarëve, që fryjnë në nyje
(duke bërë magji),
dhe nga sherri i smirëziut, kur vepron me
smirë.”

7. Lexo tri herë suren Nas

Bismil-Laahirr-Rrahmaanirr-Rrahiimë

Kul Euudhu bi Rabbin Naasi

Melikin Naasi

Ilahin Naasi

Min sherril Vesvasil han naasi

El-ledhii juvesvisu fii suduurin-naasi

Minel Xhinneti ven Naasi.

Me emrin e Allahut,

Mëshiruesit, Mëshirëplotit

Thuaj: “Mbështetem në Zotin e njerëzve!

Sunduesin e njerëzve,

Të adhruararin e njerëzve,

Prej të keqes së cytësit që fshihet,

I cili bën cytje në gjokset e njerëzve,

Qoftë ai (cytësi) nga xhinët dhe nga njerëzit.

8. Lexo tri herë:

**All-Ilaahume Rabbin naase
idhhebil beëse
veshfi
ente shaafi
laa shifaae il-laa shifaauke
shifaaen laa jugaadir sekamen.**

Zoti im, Zot i njerëzimit.

Largoje sëmundjen.

Më shëro.

Ti je Shëruesi.

Nuk ka shërim pa shërimin prej Teje.

Më shëro që të mos sëmurem më pastaj.

9. Lexo tri herë:

**Bismilahi erkijke
Vall-Ilaahu jeshfiikë
min kuli daain juëdhijkë
ve min kul-li nefsin
ev ajnin haasidin
All-Ilaahu jeshfiikë
Bismil-lahi erkiikë.**

Me emrin e Zotit lutem.
Zoti shëron.
Nga çdo sëmundje e cila të kaplon.
Nga çdo e keqe të çdokujt.
Nga çdo sy ziliqari.
Zoti të shëroftë.
Me emrin e Zotit gjendet shërimi.

10. Lexo tri herë

**Euudhu bi kelimaatilaahi
min sherri maa haleka.**

Kërkoj mbrojtje nga Zoti me fjalët e Tij
Nga e keqja e cila gjendet në gjithësi.

11. Lexo tri herë

**Eudhu bi kelimaatil laahi taammeti
min sherr rri maa haleka
min kul-li shejtaanin
ve haametin
ve min kul-li ajnin alametin.**

Kërkoj mbrojtje nga Zoti me fjalët e
përosura të Tij.
Nga e keqja e cila gjendet në gjithësi.
Nga çdo shejtan.
Nga çdo helm dhe
nga çdo sy i keq.

12. Lexo tri herë:

**Eudhu bi kelimatilahi tameti
Min gadabihi
ve min sherr-rrri ibaadihii
ve min hemezaatish shejaatinë
ve en jahduruunë.**

Kërkoj mbrojtje nga Zoti me fjalët e
përsosura të Tij.

Nga hidhërimi i Tij.

Nga dënimi i Tij.

Nga e keqja e robërve të Tij.

Nga cytjet e shejtanëve, dhe
nga prezenca e tyre.

13. Lexo tri herë:

**Bismilaahil-ledhii la jedurr-rru mea-ismihii
shejun fil erdi ve laa fis semaai
ve huves semiilu aliimë.**

Me emrin e Zotit

Nuk mund të të dëmtojë askush aspak,
qoftë në qiell qoftë në tokë, kur jeton me
emrin e Tij.

Ai Dëgjon, është i Ditur.

Përmbajtja:

HYRJE	2
Me shkronja arabe dhe me transliterim	4
Rukja dhe praktikimi bashkëkohorë	21
Ngrënia e pasurisë së njerëzve me pa të drejtë	23
Zëvendësimi i gjeneratave të njerëzve dhe xhinëve.....	25
RUKJA	26
Dallimi në mes rukjes dhe lutjes.....	28
Mendimi i dijetarëve për Rukje.....	31
Rreth sihrit (magjisë)	35
Çka nënkuptojmë me fjalën "Mes" (prekjen) e Shejtanit?.....	37
Çka nënkuptojmë me fjalën "Nasb"?	38
Njeriu e ka sunduar xhinin dhe jo e kundërta	40
Xhini Ifrit dhe Njeriu i ditur	42
LEXO RUKJE PËR VETEN TËNDE	43

